



ISLAMOLOGJIA

MODELI THEMELOR PËR NJË SHKOLLË MENDIMI DHE VEPRIMI

nga Dr. 'Ali Shari'ati (1968)

Po paraqes figurën gjeometrike të një shkolle mendimi dhe një ideologjie që çdo islamolog dhe musliman i ndërgjegjshëm duhet të kenë për Islamin, jo vetëm si një shpjegim të besimit të tyre fetar, por si një moto të një shkolle mendimi dhe ideologjie.

Gaston Bachelard, njëri nga mendimtarët më të mëdhenj të kohës sonë, i krahasueshëm me Descartesin dhe Platonin dhe i cili për fat të keq vdiq para pak vitesh duke qenë mjaft i panjohur, mendonte se kur një ide mund të konceptualizohet në një formë gjeometrike, (atëherë) ajo ka gjetur gjuhën e saj të duhur në të cilën të shprehë dhe shpjegojë veten. Pra, kur një ide gjen shpalosje gjeometrike, ajo ka gjetur gjuhën më të mirë e të shprehurit të saj.

Çdo ide që mund të konceptualizohet e pastaj të shprehet përmes një figure gjeometrike, përbën në vetvete provën se ajo është edhe e vlefshme edhe e drejtë. Konceptet shkencore më të sakta në botë janë matematike. Nëse ne jemi në gjendje t'i shprehim idetë tona filosofike ose ideologjike në gjuhë matematike apo gjeometrike, atëherë kemi gjetur mënyrën më të mirë për të shprehur konceptet tona si dhe provën më bindëse të faktit se idetë intelektuale janë logjike, në ndryshim nga filosofitë dhe fetë të cilave i duhet të hyjnë në diskutim, argumentim, sofistri, debate dhe krahasime për të vërtetuar logjikën e tyre. Aty, do të jetë zgjedhur gjuha më e dobët e të shprehurit nga vështrimi i arsyetimit dhe logjikës.

Nëse në vend të kësaj do përdorej matematika si gjuha e të shprehurit për një intelektual, filosof ose shkollë fetare apo edhe artistike a letrare, atëherë kjo shkollë mendimi do ia ketë dalë në gjetjen e shprehjes (së saj) përmes të arsyetuarit, duke e treguar veten si logjike, ashtu edhe shkencore.

Desha vetëm të shtoj një gjë. Një shkollë e tregon nëse është e një trajte të natyrshme apo jo - nëse lakorja e saj është normale ose jo, nëse forma e saj është heterogjene apo homogjene - përmes figurës gjeometrike në të cilën ajo është shprehur. Kjo d.t.th. që, mund të kuptohen cilësitë e vërteta të shkollës në fjalë nga të shprehurit e saj gjeometrik.

Shkollat dhe Dijetarët

Ka një ndryshim të madh ndërmjet dijes që është kuptuar dhe asaj që vetëm është mësuar. Ju mund të njihni njerëz që kanë shumë dije për një person të famshëm, libër apo shkollë (mendimi) por të cilët nuk e kuptojnë personin, librin apo shkollën (në fjalë). Cili është ndryshimi midis këtyre dyjave? Nëse ia dal të shpreh këtë ndryshim, atëherë unë do kem arritur të shpjegoj dallimin midis një shkollari të vërtetë islam dhe një personi i cili thjesht vetëm ka mësuar për Islamin por që nuk e kupton atë.

Ka disa studiues islamë që e kuptojnë Islamin dhe ka të tjerë - shumë madje, që vetëm kanë *mësuar* për Islamin. Nga ana tjetër, ka disa që e kuptojnë Islamin mirë por të cilët s'janë të interesuar të jenë dijetarë islamë.

I njëjti ndryshim ekziston në letërsi, në rastin e disa profesorëve që dijnë p.sh. se sa dorëshkrime të poemave të Hafizit ekzistojnë në botë, ku ndodhet secili, ç'peshë e përmasa kanë vëllimet, sa poema apo cilat prej tyre janë të përfshira në çdonjërin prej botimeve e të cilët njohin emrat dhe veçoritë e të gjithë atyre që lavdërohen nga Hafizi, ç'ndikim kishin ata mbi të, ç'lidhje kishin ata me të, etj. Ata dijnë se sa fjalë persiane apo arabe ndodhen në secilën prej poemave të Hafizit ose i njohin të gjitha aluzionet apo referimet historike të bëra nga ai, por ata nuk e kuptojnë Hafizin. Të kuptosh Hafizin është diçka tjetër. Këta 'Hafizo-logë' s'kanë bashkëndjenjë as spirituale as intelektuale me Hafizin. Kështu, të kuptosh Hafizin ndryshon nga të kesh mësuar disa gjëra rreth tij.

E njëjta gjë është e vërtetë në lidhje me një njeri. Hidhni një sy cilitdo mendimtari ose artisti. Dikush mund të vijë e të marrë në shënim të gjitha tiparet fizike të një personi dhe të përkufizojë çdo qelizë në trupin e tij, të njohë tërë fiziologjinë e tij, moshën, etj. dhe të ketë një informacion shumë të saktë mbi të, por të mos e kuptojë këtë person si një mendimtar të madh apo artist. Një njeri tjetër mund të vijë dhe vetëm me një të takuar, nëpërmjet një shkëmbimi të thjeshtë idesh, ta kuptojë personin më mirë dhe më thellë se ai tjetri megjithë tërë atë informacion shkencor.

Është po kështu me njohjen e një shkolle mendimi. Të kuptosh një shkollë mendimi s'është njëllë si të kesh informacion teknik dhe të detajuar mbi të. Të kuptosh d.t.th të kesh (formuar) një përfytyrim mbi orientimin e kësaj shkolle - ta kuptosh atë si një tërësi dhe jo vetëm të dish pjesë apo copëza të saj. Do të thotë ta ndjesh thellë një fé a ideologji, të gesh shpirtin dhe kuptimin që fshihet në një ide.

Ja se ç'nëkuptoj unë me të kuptuarit e Islamit - jo (të kuptuarit e tij) si një kulturë. Sigurisht, aspektet e vlefshme të kulturës islame dhe shkencave islame që janë burime të rëndësishme të qytetërimit islam, duhen studiuar patjetër. Me Islamologji unë kuptoj të përvetësuarit e ideologjisë së Islamit, jo thjesht vetëm shkencat islame që mësohen rëndomtazi nëpër shkolla dhe universitete. (Kjo njohje) është ashtu siç e kuptojnë një poezi, letërsinë dhe artin poetët, shkrimtarët dhe artistët, jo si ato që jepen mësim nga profesorët e Fakultetit të Letrave.

Të gjitha shkollat e letërsisë së shek. XIX dhe XX të Francës u formuan nëpër kafené e jo në auditoret e Sorbonne-s. Ata filluan së pari me masat dhe ata që kishin gjenialitet, ndjenjë, ndijshmëri për lëvizje, entuziazëm dhe kurajo për të krijuar një shkollë të re muzike, pikturë, letërsie apo poezie. Pastaj, kjo përhapet grupeve dhe grumbullimeve nëpër kafené si dhe përmes marrëdhënieve intelektuale dhe spirituale ndërnyerëzore aty-këtu dhe nëpër rrugë.

Ishte ky çast kur njerëzit e shkolluar të universiteteve filluan t'i kundërvihen valës së re të mendimit duke iu referuar asaj si një devijim. Ata përdorën shfaqjesimin se qëllimi (i kësaj) ishte prishja e artit dhe letërsisë dhe se idetë e reja do cungonin pavarësinë e kulturës dhe letërsisë së tyre.

Përplasja dhe konflikti filloi, por determinizmi i kohës dhe logjika e forcuan valën e re të mendimit dhe e armatosën atë me një logjikë të re që e dobësoi, e mundi dhe e dërrmoi logjikën e vjetër.

Dhe pastaj, pak vite më pas, shkolla e re e 'dënuar' arriti pranimin zyrtar. Ajo ia imponoi veten universitetit. Profesorët e universiteteve ishin atëherë krenarë që jepnin mësim 'poezinë e re' dhe 'artin e ri'.

Kështu ka dy lloje të kuptuarit apo të njohurit. Njëri shihet tek ata që mbahen të jenë studiues të një shkolle apo kulture, që janë specializuar në shkencat dhe idetë kulturore të asaj shkolle. Ata e kanë studiuar atë dhe janë (bërë) të diplomuarit universitarë.

Lloji tjetër shihet tek ata që mundet dhe jo të jenë specialistë të asaj shkolle mendimi, por që e ndijojnë atë. Ata e ndjejnë e kësisoj e njohin dhe kuptojnë atë më mirë se grupi i parë sepse grupi i dytë ka arritur të njohë 'shpirtin' dhe 'orientimin' e asaj shkolle apo lëvizjeje e jo thjesht ta njohë atë shkencërisht.

Islami si Kulturë përballë Islamit si Ideologji

Përgjatë historisë së qytetërimit islam, Islami - në vrazhdën e kulturës islame dhe Islami në kuptimin e shkencave islame - është kthyer në një kompleks mendimesh dhe fjalësh teologjike, shpjeguese dhe historike të renditura së bashku për të formuar ato që

njihen si shkencat islame dhe secila ka fushën e vet të specializimit. Ajo që ndodh është të studiuarit, të përftuarit e dijes teknike dhe të bërit ekspert në njërin lëm.

Por Islami arrin të përvetësohet në kuptimin e një ideologjie përmes një mënyre krejtësisht tjetër. Islami, si një ideologji, nuk është një specializim shkencor por është ndjenja që kemi në lidhje me një shkollë mendimi si një sistem bindjesh e jo si një kulturë. Është të ndijuarit e Islamit si një ide dhe jo si një përmbledhje shkencash. Është të kuptuarit e tij si një lëvizje njerëzore, historike dhe intelektuale, jo si një magazinë informacionesh shkencore dhe teknike. Dhe, më në fund, është vështrimi i Islamit si një ideologji në mendjen e një intelektualit dhe jo si shkencat e lashta fetare në mendjen e një teologu. Islamologjia, atëherë, duhet të jepet (mësim) në këtë mënyrë.

Për ta çuar më tej këtë ide, fillimisht do jap një pamje të përgjithshme të një shkolle mendimi dhe shpjegoj ç'do të thotë 'shkollë mendimi'. Do shpjegoj gjithashtu ç'nënkuptoj kur them se Islami duhet marrë si një shkollë ideologjike, jo si një kulturë apo kompleks shkencash. Dy pyetje atëherë, duhen përgjigjur: së pari, ç'është një shkollë mendimi apo doktrinë? Së dyti, ç'është Islami në vetvete si një shkollë ideologjike? Do përpiqem të jap një përshkrim të saktë të koncepteve ideologjike.

Idea e një Shkolle Mendimi

Në fillim do shpjegoj shkollën e mendimit si një ide dhe pastaj ta paraqes atë në formën e një modeli gjeometrik. Kur them *methheb* - shkollë mendimi, kam parasysh një përmbledhje harmonike konceptesh filosofike, bindjesh fetare, vlerash etike dhe metodash praktike të cilat përmes një marrëdhënieje racionale, krijojnë një trup të lëvizshëm, kuptimplotë, të drejtuar dhe të bashkuar që është i gjallë dhe të gjitha pjesët e të cilit ushqehen nga shpirti.

Një ekspert mund apo mund të mos ketë një shkollë mendimi por nëse ai e ka një, edhe pse, p.sh., ai mund të jetë një fizikan, ju mund të përcaktoni ç'pikëpamje ka ai përsaipërkjet çështjeve ekonomike apo klasore, përpara se të ketë thenë ndonjë gjë për atë që mendon. Nëse ai është një ekonomist dhe ka një shkollë mendimi, ju mund të parashikoni se cilat janë qëndrimet e tij filosofike ndaj natyrës.

Pse? Sepse të gjitha vështrimet mbi ekonominë, sociologjinë, fenë, filosofinë e madje edhe artin me letërsinë të një personi që beson në një shkollë të caktuar mendimi, kanë një marrëdhënie shkaku dhe pasojë me njëra-tjetrën.

Kështu, duke i njohur njërin përmasë të pikëpamjeve, mund të përcaktoni përmasat e tjera të konceptimeve të tjera intelektuale apo intuitat e tij. Nëse dikush beson në një shkollë mendimi - bindjet, emocionet, mënyra e jetesës, politika, qëndrimet sociale, intelektuale, fetare dhe konceptet etike nuk do jenë të ndara por të ndërlidhura. Ato janë të gjalla në një shpirt, duke ekzistuar harmonikisht në një trajtë.

Një fashist, ekzistencialist apo marksist ka një shkollë mendimi (të vetën). Ju mund të njihni një fizikan që është, të themi, fashist. Në këtë rast, ju mund të thoni se nga pikëpamja psikologjike, ai beson në psikologjinë e racizmit dhe diskriminimit racial. Për nga këndvështrimi politik, ai beson në nacionalizëm dhe realizëm, ndërsa për nga pikëpamja sociale ai beson në autenticitetin e familjes.

Meqë ai ka një shkollë mendimi, bindjet e tij politike, ekonomike, madje edhe letrare janë në harmoni, të bashkërenditura dhe të ndërthurura. Ato i japin jetë një forme të përgjithshme dhe kjo formë quhet 'shkollë ideologjike'.

Nga ana tjetër, merrni një fizikan që nuk ka një shkollë mendimi. Cili është orientimi i tij? Për nga pikëpamja ekonomike, ai s'ka asnjë. Ai s'ka opinion, apo, nëse ka - cili është ai?

A lëviz ai në të majtë, në të djathtë apo në qendër? Ju s'mund ta dini. Ju duhet ta pyesni atë. Një person i tillë diskuton çështje nga të gjitha anët. Ju duhet në fillim të dëgjoni diskutimet e tij për të parë cili është opinionin e tij dhe pastaj të nxirrni përfundimin se botëkuptimi i tij është ky apo ai sepse ka të ngjarë që ai në çdo fushë të ndryshme të mbajë një qëndrim të ndryshëm, një bindje të veçantë ngaqë ai nuk beson në asnjë shkollë mendimi.

Një person që ka një *methheb* mendon për të gjitha çështjet e jetës: ideologjiket, letraret, artistiket, historiket - cilatdo. Përfundimet e tij mbi to janë të bashkërenditura dhe në harmoni me ideologjinë e bindjet e tij.

Për shembull, ju mund të shihni një njeri që beson në një shkollë të përkushtuar shoqërore. Edhe pse ai nuk ka thënë asnjë fjalë të vetme për letërsinë ose artin – ngaqë i përket një shkollë të përkushtuar shoqërore mendimi - ju e dini se ai nuk beson në letërsi për hir të letërsisë, në art për hir të artit apo poezi për hir të poezisë, ose në letërsi si një gjuhë të ndjenjave personale, por ai me sigurinë më të madhe beson se arti dhe letërsia duhen të jenë në shërbim të përpjekjes shoqërore sepse ai beson në një shkollë të përkushtimit shoqëror.

Kështu, një shkollë mendimi dhe veprimi është si një galaksi në të cilën çdo ndijshmëri individuale, sjellje shoqërore, tipar etik dhe në veçanti ide filozofike, fetare dhe sociale të një personi janë secila si një planet që sillet rreth një dielli në një galaksi të bashkërenditur që lëviz në një drejtim dhe mënyrë të saktësuar. Ky është botëkuptimi i një personi që beson në një shkollë mendimi. Kjo është shkolla e mendimit që krijon lëvizje, ndërton dhe sjell fuqi shoqërore. Është kjo ajo që i jep një mision, detyrë dhe përgjegjësi një njeriu. Ekspertiza dhe shkenca nuk e kanë këtë efekt.

Që prej kohës kur Islami u kthye nga një 'shkollë ideologjike' në 'dije kulturore' dhe një 'grumbullim shkencash fetare', ai e humbi aftësinë dhe fuqinë e tij për të krijuar 'lëvizshmëri', 'përkushtim', 'përgjegjësi' dhe 'vetëdije shoqërore' dhe u pengua nga të paturit e çfarëdo efekti apo ndikimi në fatin e shoqërisë njerëzore.

Kur themi se 'një shkollë mendimi është një formë e plotë intelektuale e një personi që beson në një ide', cila është kjo formë?

Unë s'e kam marrë këtë figurë shumë të thjeshtë nga ndokund. Unë e kam krijuar atë nga studimet mbi ideologjitë e ndryshme dhe kërkimet mbi idetë dhe bindjet si dhe shkollat ideologjike, fetare e shoqërore; kam projektuar një formë që nuk është e dobishme vetëm nga pikëpamja e të shprehurit të një ideje, por është gjithashtu e dobishme si një mjet për të mësuarit dhe shpjeguarit e asaj që quhet 'shkollë ideologjike e të menduarit', jo vetëm si formë, gjë që është e thjeshtë, por si mënyrë shprehjeje nga vështrimi i përmbajtjeve të saja, që në vetvete është e një rëndësie të veçantë në një *methheb*. Ajo bazohet në bindjen se një shkollë e përkryer ideologjike - që përfshin të gjitha format intelektuale të një shkollë të mendimit - ka një trajtë të tillë të plotë.

Infrastruktura dhe Superstruktura e një Sistemi Bindjesh

Kur i referohem infrastrukturës, unë i referohem themelit të një sistemi besimi ose qëndrimeve të zhvilluara nga parimet e atij sistemi bindjesh që kanë një marrëdhënie shkakësore me superstrukturën. Me superstrukturë unë nënkuptoj idetë apo pasojat e zhvilluara përmes tre shtyllave që formojnë *ideologjinë* e që janë të bazuara në infrastrukturën e një sistemi besimi.

Çdo shkollë ideologjike duhet të ketë një infrastrukturë ose një sistem themelor mbështetjeje nga i cili zhvillohen të gjitha idetë e tij. Kjo përbëhet nga një *botëkuptim* që

çdonjëra nga shkollat e mendimit zotëron pa përjashtim, qoftë ajo e orientuar hyjnore, materialiste, natyraliste, idealiste, fashiste, marksiste, etj...

Një person që nuk ka një botëkuptim është si një person që ka plot furnizim dhe e zhvendos atë nga njëra shtëpi në tjetrën. Asgjë nuk shpaketohet kurrë deri në fund apo vihet në vendin e vet të duhur me qëllim që të përdoret siç duhet...

Të paturit e një dijeje të gjerë të degëzuar pa pasur një botëkuptim të përcaktuar është si të kesh të gjitha materialet e nevojshme që lypsen për të ngritur një ndërtesë, por nuk ke projektin se çfarë duhet të ndërtohet. Do ishte më mirë për një person t'i mungonin materialet sesa projekti.

Këtu qendron ndryshimi i vërtetë midis Abu Dherit dhe Ibn Sinas, ndërmjet një luftuesi besnik në rrugën e Zotit (*mujahid*) dhe një dijetari ekspert; ndërmjet një intelektualit të përkushtuar dhe një shkencëtari hulumtues; ndërmjet një personi të orientuar, të vetëdijshëm dhe përgjegjës e një eksperti të pafé, të paudhëzuar; ndërmjet një ideje dhe shkencës e, më në fund - një ideologjie dhe një kulture.

Shkenca, arti, letërsia, filozofia, industria, qeniet njerëzore, jeta, etika madje edhe vetë ekzistenca do të gjejnë kuptim, shpirt dhe orientim kur t'i bashkangjiten një besimi dhe sistemi ideologjik të një shkolle të mendimit. Kjo është e mundur kur të gjitha këto të jenë bazuar në një botëkuptim dhe shpjeguar nga standardet e saj.

Botëkuptimi

Çdo mendimtar që ka një shkollë mendimi duhet të ndërtojë një formë të atillë dhe pastaj t'i përgjigjet pyetjes: "Cili është botëkuptimi yt?" Një person që ka një botëkuptim mund të përgjigjet se botëkuptimi i tij është materialist, realist, skeptik, taoist, shumëteist, dualist, monoteist, panteist, asketik, ekzistencialist, etj...

Një botëkuptim është të kuptuarit që një person ka mbi 'të qenurit' apo 'ekzistencën'. Ndryshimi midis Hafizit dhe Omer Khayamit qëndron në botëkuptimet e tyre. Khayami thotë: "Meqë askush s'është kthyer ndonjëherë nga bota tjetër për të sjellë lajme prej saj (botëkuptimi i tij), ne duhet të shijojmë të këtushmen (ideologjia e tij)". Hafizi thotë: "Meqë fati ynë është përcaktuar në mungesën tonë (botëkuptimi i tij), nëse ai nuk është sipas pëlqimit tonë, mos u brengosni (ideologjia e tij)". Kështu, një ideologji zhvillohet nga konteksti tërësor i një botëkuptimi dhe këto të dyja kanë një marrëdhënie shkaku dhe pasojë.

Një person që beson se bota ka një Krijues i Cili është i Ndërgjegjshëm dhe ka një Vullnet e nga përshkrimet e sakta dhe llogaritë që janë mbajtur, ai do të marrë shpërblimin e veprave të tij ose do të dënohet për to, është një person me botëkuptim fetar. Duke u mbështetur pikërisht mbi këtë botëkuptim thuhet se: "Mënyra ime e jetesës duhet të jetë kështu dhe ashtu. Kjo apo ajo duhen bërë." Ajo shpjegon kuptimin e jetës, shoqërisë, etikës, bukurisë dhe shëmtisë, të vërtetës dhe së rremes. Ja se ç'do të thotë të kesh një ideologji fetare.

Kështu, idealizmi i Hegelit, materializmi dialektik i Marxit, ekzistencializmi i Heideggerit, Jaspersit dhe Sartreit, absurditeti i kotësisë së Albert Camusë dhe Samuel Beckettit, feja e Katolicizmit ose/dhe Islami, Taoizmi i Lao Tsusë, 'karma' e Hinduizmit, dhimbja dhe nirvana e Buddhas, uniteti i qenies së Hallajit, determinizmi pesimist i Khayamit, Schopenhauerit dhe Metternichut - janë të gjitha botëkuptime.

Antropologjia Filosofike

Kjo konsiston në llojin e qëndrimit që secila shkollë e mendimit ka mbi qenien njerëzore gjë që formon botëkuptimin e saj, si psh: "Ç'është një qenie njerëzore?", "Ç'duhet të jetë një qenie njerëzore?"

Ajo që kam parasysh këtu është lloji i dijes që ekziston në një shkollë mendimi për njeriun, jo terminologjia e posaçme e antropologjisë e as kuptimi i përgjithshëm i humanizmit. Ajo së cilës po i referohem është vlera e vërtetë, misioni dhe domethënia që një shkollë mendimi ka në lidhje me njeriun, jo në kuptimin e kundërt të saj. Autenticiteti njerëzor është një frazë e përdorur nga grekët e lashtë, Rilindja apo shkollat e radikalizmit në fundin e shek. XVIII dhe fillimin e atij XIX, ose kuptimi që ekzistencializmi i dha atij në shek. XX.

Është e qartë se një person njihet sipas botëkuptimit të tij dhe çdo shkollë mendimi e emëron ose përkufizon 'qenien njerëzore' në mënyra të ndryshme. Njëra shkollë e quan njeriun 'kafshë materiale'. Një tjetër e përcakton atë 'kafshë hyjnore'. Secila shkollë e përkufizon ose përshkruan qenien njerëzore me një mbiemër të ndryshëm si: krijues të idealit, racional, ekonomik, prodhues veglash, i lirë, vendim-marrës, që i mungon lënda, ngurrues, i paragjykuar, i ngjashëm me Zotin, i natyrshëm, shoqëror, krijues kulture, i qytetëruar, i vetëdijshëm, etj.

Duhet përmendur këtu se kur një shkollë mendimi flet për një qenie njerëzore, ajo i referohet domethënies dhe vërtetësishtësisë së njeriut nga këndvështrimi filosofik dhe ideologjik, jo krijesës së vërtetë të përshkruar apo diskutuar në shkencat e fiziologjisë, psikologjisë, biologjisë, teologjisë, antropologjisë, sociologjisë, morfologjisë, etj. Ajo që nënkuptoj është e vërteta e llojit njerëzor në ideologjinë e tij/saj, shkollën e mendimit dhe qëndrimet ideologjike të tij/saj dhe jo në një kuptim rreptësisht shkencor.

Është e vërteta e qenies njerëzore që përshkruhet e jo realiteti i tij/saj. Është ashtu siç flasin filozofia, feja dhe arti për njeriun, ashtu siç flet Buddha, Confuciusi, Socratesi, Platoni, Rousseaui, Hegeli, Marxi, Tolstoi, Sartrei; apo Abrahami, Jezusi, Profeti i Islamit (s), 'Aliu; apo Homeri, Goethe, Hafizi, Rumi, Tagoreja, George Sandsi dhe van Gogh përshkruajnë, shpjegojnë dhe i japin pamje njeriut - e jo siç flasin për qenien njerëzore Claude Bernardi, Darwini dhe Freudi.

E njëjta gjë vlen edhe për historinë. Me filozofi të historisë unë nënkuptoj konceptin, të vërtetën, lëvizjen dhe synimin që filozofët dhe profetët kanë për historinë. Është të vështuarit e historisë si një realitet i vetëm që ka domethënien dhe orientimin e tij të veçantë siç e kuptuan dhe e përshkruan atë Ibn Khaldun, Virgo, Hegel, Marx, Emerson dhe Toynbee e jo si historianët e mëdhenj dhe historiografët siç janë Herodotesi, Gibboni, Tabbariu dhe Bayhaqi.

E njëjta gjë është e vërtetë edhe për sociologjinë. Është ajo që sociologjia do të thotë si një shkollë mendimi dhe jo si një shkencë në kuptimin siç e përshkruan një profesor sociologjie në universitet.

Është bindja ime që këto të trija formojnë tre shtyllat themelore të një shkolle mendimi: të vështuarit mbi njeriun, historinë dhe shoqërinë. Këto të trija janë treguar në fig. 1. Secila prej tyre ngrihen nga një botëkuptim dhe kanë një marrëdhënie logjike shkakut dhe pasojë me të. Këto janë tre shtyllat që ndërtojnë një shkollë mendimi, themeli i së cilës është botëkuptimi.

Shkolla e mendimit dhe veprimit

Prototipi Ideal
Shoqëria Ideale

IDEOLOGJIA

Filosofia e Historisë
Antropologjia Filozofike } *Super Struktura*
Sociologjia
Botëkuptimi } *Infrastruktura*

E gjithë superstruktura individuale ndërtohet mbi to. Kjo është si një individ që mban peshën e besimit për dikë. Çdo individ që ka arritur fazën e 'vetëdijes' (ndërgjegjësimit) dhe ndijon brenda vetes rëndesën e një misioni për njerëzimin i duket vetja si Atlasi që mbajti peshën e gjithë botës mbi shpatulla.

Ky koncept është koncept i një shkolle ideologjike të mendimit. Ai është një formë që mban të vërtetën e një qenieje njerëzore sepse një njeri s'është në fakt asgjë më shumë se besim dhe përpjekje.

Sociologjia

Me këtë i referohem një bindjeje të veçantë të njeriut, të bazuar në përshtatshmërinë e shkollës në fjalë në lidhje me shoqërinë njerëzore dhe qendrimet që mbahen ndaj saj. Sociologjia e një shkolle mendimi së pari përkufizon atë që ajo njeh si realitetin e shoqërisë dhe së dyti - (çështjen se) si ka arritur ta njohë atë nga këndvështrimi intelektual dhe ideologjik. Kjo është kështu ngase pikëpamja shoqërore në një shkollë mendimi i mbetet besnike shoqërisë si një doktrinë për ideologjinë e saj. Nuk është vetëm çështje e analizimit të shoqërisë pa patur një qëllim apo shtërngim.

Në një shkollë mendimi, sociologjia është në harmoni me prirjet, idealet dhe vështrimet e veçanta të asaj shkolle. E bazuar mbi këtë ajo gjykon, kritikon dhe vlerëson. Ajo është e orientuar dhe ka përkushtim siç kanë p.sh. vështrimet e Durkheimit dhe Gurvitschit, ndryshe nga sociologjia që ofrohen me shpesh nëpër universitete ku pikësynim është vetëm analizimi e njohja me marrëdhëniet dhe dukuritë, studimi i saktë se ç'ekziston ashtu siç është dhe ashtu siç shihet, thjeshtë hulumtimi i pasojave, pa i kushtuar vëmendje shkaqeve.

Sociologjia e shek. XIX ishte kryesisht e llojit ideologjik apo siç thonë evropianët: një pikëpamje e përkushtuar shoqërore. Nga ana tjetër, sot, krahas qëndrimit të përgjithshëm të shkencave të tjera, theksi vihet mbi të larguarit e shkencës nga ideologjia e madje të hequrit e çfarëdo ndjenje përkushtimi, duke u përmbajtur nga çfarëdolloj përcaktimi të së mirës dhe së keqes. Në lidhje me gjykimet morale, pohohet se sociologjia duhet vetëm të gjykojë realitetet në vend që t'i kthehet së keqes dhe së mirës, duke ofruar zgjidhje dhe drejtim e duke pranuar përgjegjësi për përkushtim shoqëror, etik dhe madje njerëzor. Në përgjithësi, ajo kundërshton të pranojë një ide ose të përvetësojë një drejtim të përcaktuar ose qëllim në

teori apo praktikë. Në vend të vlerësuarit dhe të udhërrëfyerit, ajo shndërrohet në fakt-kërkuese dhe analiza (të padobishme).

Ajo gjithashtu ka shpallur këtë tezë: Të paturit e një përkushtimi, ideologjie ose një qëllimi do ta dëmtojë shkencën dhe do ta kufizojë atë në kornizën e ideologjive të përcaktuara ose të veçanta - në bindje të caktuara. Ajo do ta marrë vetvetiu çështjen në dorë të saj. Kjo do ta drejtojë atë nga qëllimi në të cilin ajo beson. Si pasojë, shkenca, në vend të kërkimit objektiv të së vërtetës, cilado qoftë kjo, do të detyrohet të kërkojë rezultate të parapërcaktuara që i shërbejnë dhe konfirmojnë sistemin e bindjeve në fjalë.

Kjo, sipas këtij vështrimi, ndodh ngase një 'hulumtues i përkushtuar' (dikush i dhënë ndaj fesë ose ateizmit, përshpirtshmërisë apo materializmit, socializmit ose kapitalizmit, lirisë apo diktaturës, etj.) natyrisht s'mund të jetë i lirë. Nuk mund të jesh një hulumtues me opinione të pafundme apo të pakufizuara aq sa asgjë të mos të t'i ndikojë kërkimet dhe të mos molepsi asnjë përfundim që mund të arrish.

Për shembull, një sociolog i përkushtuar s'mund të jetë një studiues objektiv dhe i lirë i historisë. Pse? Sepse në studimin e historisë, kërkohet gjithnjë të gjehet lufta e klasave. Kurdo që gjehet, ajo vërteton qendrimet e tij dhe kurdo që ajo nuk gjehet, ai e shfajëson atë. Çdo herë që gjehet diçka që e kundërshton këtë vështrim, ai e mospërfill atë. Nganjëherë ajo as nuk dallohet dhe s'mund të dallohet sepse vihen syze me ngjyrat e caktuara të ideologjisë së cilës i përkitet.

E njëjta gjë, sipas këtij mendimi, qëndron me një fizikan fetar që kërkon paseshtur Zotin në hulumtimet e tij shkencore. Ndryshe nga ky person, një fizikan materialist sheh kudo zbrazëti pa Zot. Kështu, vetëm ky kërkues, që është i lirë nga të dy këta vargonj mund të kuptojë objektivisht botën fizike ashtu siç është në të vërtetë.

Shohim kështu se sa të qendrueshme janë këto argumente dhe, nga njëri këndvështrim, ata janë të arsyeshme në kuptimin se ne pamë që në Mesjetë, për shkak të përkushtimit fetar, shkenca dhe hulumtimi ishin të detyruara të vërtetonin vetëm ato pohime që ishin sugjeruar (që) më parë nga studiuesit fetarë. Ato arritën në përfundime që kishte parapërcaktuar Krishtërimi.

Në shek. XIX, shkencat, veçanërisht ato shoqërore si historia dhe sociologjia, iu kundërvunë aq fuqishëm shkencëtarit që kishte një sistem bindjesh dhe idesh të parapërcaktuara të ngulitura nga palët e ndryshme lidhur me ligjet e klasës apo anti-klasës ideologjike, racizmit apo nacionalizmit, sa që një lloj neo-skolasticizmi u shfaq. Shkenca, që ishte liruar nga të shërbyerit fesë në Mesjetë, në këtë shekull të ri u shfrytëzua tani nga një shkollë mendimi.

Domosdoshmëria e të liruimit të shkencës nga detyrimi i ngushtë i ideologjive, të dhënurit e saj për të vërtetuar pozicionin e njërës palë dhe shfajësuar dëshirat raciale, kombëtare, klasore, politike dhe ekonomike të ideologëve dhe filosofëve krijoi një gjendje tepër të volitshme sa që për shkak të një gënjeshtrie mjeshtërore, ata që e mbështesnin këtë pikëpamje mundën ta ndanin shkencën nga misioni dhe përgjegjësia e saj thelbësore për t'i shërbyer njerëzimit dhe për t'i sjellur ndërgjegjësim dhe drejtim njerëzve.

Në studimin e tyre të realiteteve në kërkim të së vërtetës, ata e izoluan dhe e ndanë shkencën nga njerëzit me argumente si: 'e vërteta objektive', 'hulumtimi i lirë', 'shkenca e kulluar', 'paanshmëria e shkencëtarit', 'shmangia e paragjykimeve', 'idetë e parafabrikuara' - që ishin të gjitha tërheqëse dhe logjike. Kjo ishte veçanërisht e vërtetë për shkencat shoqërore si historia, sociologjia dhe letërsia të cilat më tepër sesa fushat e tjera, mund të sillnin ndërgjegjësim për intelektualët dhe drejtim për masat në mbarë botën.

Ajo që ndodhi (më pas) ishte se, duke përdorur këto argumente, shkenca moderne s'mund të propozonte më zgjidhje, të bënte gjykime vlerash (morale), të përcaktonte drejtime, të shpjegonte synime, të vërtetonte apo hidhte poshtë ide, të jepte udhërrëfime

për mënyrën e të vepruarit, të tregonte rrugën, të kritikonte realitetet ekzistuese, të sugjeronte propozime për përmirësim apo të parashikonte gjendje të përshtatshme. Ajo kryesisht studionte dhe analizonte probleme, bënte të qarta çështje të panjohura shkencore dhe - zbulonte shkaqe e pasoja logjike në dukuritë. Misioni i drejtimit të ngjashëm me atë profetik kishte rreshtur së qenuri.

Shkenca është ndarë nga fabrika e shoqërisë. Ajo ka humbur kontaktin me mendimet e njerëzve. Duke mos qenë e aftë të kritikojë gjendjen e tanishme, ajo s'mund të shërbejë më për të ndihmuar së zgjidhuri problemet e jetës. Ajo s'mund ta drejtojë më shoqërinë në rrugën e duhur, t'i qartësojë përbërësit themelorë, duke shkaktuar që padija në masë të bjerë dhe duke ndihmuar që njerëzit t'i kuptojnë shkaqet e vuajtjeve të tyre të kaluara dhe të tashme. Ajo nuk u mor më me fatin e shoqërisë dhe aftësinë e saj për të patur në dorë të ardhmen e vet dhe arritur idealet e saja.

Ashtu siç njerëzit e përsëritur dhe të devotshëm që janë të izoluar nga përkushtueshmëria e tyre fetare - duke u bërë kështu pre e lehtë për plaçkitësit - përkrahësit e "objektivitetit", në emër të "paanshmërisë" e veçuan shkencën nga zotimi i saj dhe përgjegjësia për të sjellë ndërgjegjësim, ndriçim, udhërrëfim dhe ndihmim për qeniet njerëzore në mënyrë të atillë që shkenca të mund të përmbushte më mirë qëllimet dhe pikësynimet e tyre.

Sociologjia dhe historia u zhvilluan (rrodhën) prej kësaj. As historianët objektivë, as sociologët pa mision nuk përshkruajnë se çfarë ka kaluar apo kalon për njerëzit e as se çfarë duhet të bëjnë apo se ku ndodhet shpëtimi i tyre. Ata mospërfillën faktin se kur vendosën mënjane zotimin (përkushtues) ndaj njerëzimit dhe u bënë të pakufizuar nga e moskokëçarës ndaj ndonjë qëllimi ose synimi, atëherë ata u përdorën si vegla prej atyre që luajnë me historinë dhe elementet e fuqishme të shoqërisë me qëllim që t'i ndihmojnë këta të arrijnë synimet e tyre.

Duke e ndarë shkencën nga shërbimi i saj ndaj njerëzve dhe përgjegjësisë për t'i sjellë përkryerje, vetëdije dhe shpëtim shoqërisë, ajo u përdor vetvetiu në shërbim të armiqve të popujve. Ajo u bë një vegël për të çuar më tej teposhten, padijen, nënshtrimin intelektual dhe social të qenies njerëzore. Siç e shohim sot, shkencat e paanshme janë çliruar nga përkushtimi i tyre për kërkimin e së vërtetës së gjithësisë apo vërtetimin ose mohimin e ekzistencës së Zotit, por për të gjitha qëllimet praktike, ato janë bërë skllave të kapitalizmit.

Sociologjia nuk shqetësohet më nga besimi siç bënte në Mesjetë, as nga ndonjë ideologji siç ka bërë shekujve të fundit. Ajo është bërë një shkencë që propozon hulumtim dhe mësim prapa dyerve të mbyllura. Ajo përdoret për të ngopur egot e profesorëve, për të zbavitur studentët apo për t'i treguar institucioneve të fshehta të orientura imperialistisht si të poshtërojnë, shthurin, devijojnë dhe plaçkisin masat perëndimore dhe/ose kombet e privuara të Lindjes. Ajo i shërben organizatave kapitaliste apo anti-popullore duke zhvilluar mënyra dhe mjete me të cilat të mund të tresin, ndosin dhe shkatërrojnë shpirtin njerëzor, duke pasur si pasojë prapambejtjen dhe keqësimin e njeriut.

Unë e pranoj argumentin se paragjykimi dhe dogmatizmi ideologjik e dëmton kërkimin shkencor dhe se shkencëtari i cili beson që më parë se ai e njeh të vërtetën, s'mund të jetë një shkencëtar i mirë, sepse kërkim do të thotë hulumtim, shqyrtim, shpjegim dhe peshim të problemeve për të gjetur të vërtetën. Fiziologu i cili para se të bëjë ndonjë studim beson se 'shpirti' ekziston apo s'ekziston, mesiguri s'mund ta gjejë të vërtetën. Një kapitalist ose komunist i bindur, kur të fillojë të studiojë historinë me qëllim gjetjen e së vërtetës dhe kuptimin e lëvizjes intelektuale të shoqërisë, do të gjejë në fund po ato të vërteta në të cilat besonte që më parë.

Hadithi që pohon shumë qartë se: "*Kushdo që interpreton Kur'anin sipas 'opinionit' të tij, i bën gati zjarrin vetes*", shpjegon parimin e lartpërmendur shkencor.

'Opinion' këtu është njëlloj me para-gjykim. Është një paragjykim që vetdijshëmrisht apo pavetdijshëmrisht e bën shkencëtarin të ndërrojë kuptimin e Kur'anit, në mënyrë të atillë që të puthitet me opinionin e tij të parapërcaktuar. Ja pse ne shohim që kur sunitët, shi'itët, sufitet apo filosofët studiojnë Kur'anin, ata arrijnë të gjithë në të njëjtat përfundime që kishin para se të fillonin. Kur'ani është bërë një mjet për të vërtetuar idetë e tyre e nuk është se ata i marrin idetë e tyre nga ai.

Është njëkohësisht gazmore dhe tragjike që dikush e interpretoi fjalën 'opinion' në hadith si 'intelekt', duke arritur përfundimin se asnjeri nuk ka të drejtë të interpretojë Kur'anin me intelektin e tij, sikur të kishte ndonjë gjë tjetër përveç intelektit me të cilën njeriu kupton diçka!

Ata e kanë bërë me qëllim këtë që njerëzit të mos e kuptojnë Kur'anin. E njëjta gjë ndodhte në Mesjetë kur të lexuarit dhe kuptuarit e Biblës dhe Pentaukut i përkiste vetëm priftërinjve dhe klerikëve. Ata pengonin përkthimin, interpretimin dhe shpërndarjen (e tyre) me qëllim që njerëzit të mos mundnin t'u drejtoheshin atyre. Në këtë mënyrë, librat e shpëtimit mbetën në pronësinë e klerit zyrtar fetar.

E njëjta gjë është bërë me Kur'anin. Duke i penguar njerëzit të studiojnë Kur'anin dhe të mendojnë mbi të, studiuesit fetarë e shndërruan atë në një libër nga i cili për njerëzit mbetej vetëm forma. Shpirti, qëllimi dhe synimi i tij mbetën të panjohur. Ata e kthyen atë në fraza dhe vargje fjalësh sekrete pa iu kuptuar domëthenia. Siç është theksuar dhe siç ka paralajmëruar Kur'ani, ata e interpretuan Kur'anin me idetë e tyre të paracaktuara dhe jo me intelektet e tyre dhe përdorimin e logjikës.

Kështu, ka dy teori themelore. E para - shkenca në shërbim të një sistemi bindjesh, e bën shkencën mjetin për justifikimin e mendimeve të paravendosura. E dyta - shkenca e liruar nga çdo sistem bindjesh dhe vetëm për hir të shkencës, e bën shkencën joefikase dhe të pavlerë. Në emër të objektivitetit, asaj i mungon një qëllim. Si rrjedhojë, shkencëtari nuk i shërben më njerëzve dhe shoqërisë e për të gjitha qëllimet praktike, shkenca bëhet sterile dhe përdoret për t'i shërbyer pushtetarëve, të kamurve apo mashtruesve.

Unë propozoj një rrugë të tretë: shkencëtarët, para se të ndërmarrin ndonjë kërkim, duhet të jenë të lirë nga çfarëdo lloji bindjesh të veçanta dhe (vetëm) pasi të kenë arritur rezultate, të kapen pas tyre.

Para se të ndërmarrin çfarëdo studimi, shkencëtarët nuk duhet të jepen në atë shkallë sa që nëpërmjet hulumtimit që po ndërmarrin, ata - të nisur nga nevoja - të vërtetojnë qëndrimet e tyre të paramenduara. Përkundrazi, përfundimet e vetë hulumtimit, e jo të hulumtuesve, duhet t'u tregojnë atyre të vërtetën e pastaj kjo e vërtetë e provuar të bëhet një bindje për kërkuesit. Pasi të dallojnë të vërtetën, ata duhet t'i jepen asaj dhe të kuptojnë përgjegjësinë e tyre ndaj saj si dhe përgjegjësinë e tyre ndaj njerëzve dhe kohës së tyre për vetë ndërgjegjen e tyre shkencore. Kjo d.t.th, bindja ose idea që hulumtimi i tyre u vërtetoi atyre.

Kjo mënyrë atëherë, as nuk e skllavëron shkencën e as nuk rishqipton ide të paraformuara. Ajo nuk e pengon shkencën të kryejë funksionin e saj të drejtimit dhe udhërrëfimit drejt shpëtimit të njerëzve. Kjo nuk e zhvendos atë nga të vërejturit e nevojave të qenies njerëzore, shërbimit ndaj shoqërisë njerëzore, nga të kritikuarit, ofruarit të zgjidhjeve dhe tregimit të së vërtetës e së rremes. Ajo nuk e ndryshon shkencën në universitet e as nuk e bën të përdoret vetëm nga oportunistët pushtetarë apo ata që dëshirojnë të mashtrojnë.

Sociologët, historianët apo antropologët s'duhet të lejojnë që dija e tyre të përdoret për të përligjur dhe pohuar mendimet e tyre të paracaktuara dhe joshkencore. Ata s'duhet t'i lejojnë njerëzit që besojnë ta shfrytëzojnë shkencën si mjet për qëllimet e tyre. As nuk

duhet të ndalojnë në vend me këtë dije, d.m.th të kënaqen me një shqyrtim dhe shpjegim logjik e shkencor të shkaqeve (të ngjarjeve) të historisë, shoqërisë dhe njerëzve të sotëm.

Përkundrazi, pasi të zbulojnë të vërtetën, pas një kërkimi objektiv dhe të paparagjykuar, ata duhet të paraqesin si shkaqet e pasojat pozitive ashtu edhe ato negative. Ata duhet t'i drejtojnë njerëzit në një rrugë si ajo profetikja. Ata duhet të sjellin ndërmend shkaqet e prapambetjes dhe degjenerimit të shoqërisë, të klasës apo të njerëzimit në përgjithësi - e arritur kjo përmes një hulumtimi të paanshëm - e pastaj të tregojnë rrugën e progresit dhe shpëtimit. Ata duhet të orvaten (pikërisht) në këtë mënyrë dhe t'i jepen plotësisht asaj, as 'shkencë për ideologji' e as 'shkencë për hir të shkencës'. Përkundrazi: një shkencë drejtuese që i përkushtohet së vërtetës. Përkushtimi ndaj një besimi përpara hulumtimit dëmton shkencën dhe mashtron njerëzit por një përkushtim ndaj një bindjeje *pas* hulumtimit është misioni i ngjashëm me atë profetik që ka shkencëtari.

Filosofia e Historisë

Disa besojnë se historia është e kotë. Një nga njerëzit që nuk besonin në histori ishte Napoleoni. Ai pohonte: "Historia s'është gjë tjetër veçse rrena të pranuar nga të gjithë."

Ka disa njerëz të famshëm që e shikonin historinë si një art e jo si shkencë. Besohej se historia nuk është një realitet objektiv si një mal apo natyra; një det, një njeri, një shoqëri apo vetë jeta, por është (si) një poemë. Poema nuk është një realitet i vjetëruar të cilin e zbulon poeti. Përkundrazi, poeti përdor lëndë të ndryshme dhe *krijon* një poemë. Ai e shpik atë dhe krijon çka nuk ekziston. Duke përdorur të njëjtin argument, historia është poema që një historian këndon dhe jo një realitet i jashtëm që ai zbulon. Një historian e këndon atë në një mënyrë dhe një i dytë në një tjetër. Kështu, secili e këndon atë si t'ia dojë qefi apo si të mundet.

Një bashkëkohës francez thotë të njëjtën gjë por me më shumë seriozitet: "Historia është si një mal për të cilin unë si çdo njeri tjetër bëj blloqet e mia të gurta për të ndërtuar projektin që kam vetë. Domethënë, unë i qasem historisë dhe përzgjedh çfarëdo e cilëndo formë që dua, e cunjoj dhe ndryshoj atë dhe pastaj i përdor pjesët e zgjedhura në ngritjen e një ndërtese të historisë ku vetë unë jam projektuesi, ndërtuesi dhe arkitekti.

Për shembull, historia e Revolucionit Francez nuk është një realitet që historianët e zbulojnë dhe më pas e shprehin. Historiani e krijon atë. Është mali i sipërpërmendur ai që një historian fillon të ndërtojë sipas shijeve, bindjeve, nevojave dhe aftësive krijuese të veta duke përzgjedhur blloqet e gurit për ndërtimin e historisë që ai dëshiron të ketë ndodhur.

Por, filozofia e historisë nuk beson se historia përbën rastësi të veçuara të së shkuarës, aksidente të bëra nga personalitete, të fuqishmit, prijësit ushtarakë, heronjtë dhe pushtuesit. Ajo nuk e sheh historinë si material i depozituar në të kaluarën të cilin një shkrimtar e përzgjedh sipas nevojave dhe shijeve të veta.

Historia është procesi i vazhdueshëm dhe i ngërthyer i cili lëviz dhe rritet që nga fillimi i jetës së njerëzimit sipas ligjit shkencor determinist të shkakut dhe pasojës. Ajo kalon detyrimisht përmes etapash të ndryshme dhe takon pika të përcaktuara që mund të parashikohen. Më në fund, ajo mesiguri dhe doemos arrin qëllimet e saja të cilat ishin të paracaktuara nga ligji i lëvizjes së historisë.

Po ashtu siç një bimë apo një pulë rritet ose siç lëviz Toka me një periudë të caktuar, ashtu edhe historia është një realitet jetues, natyror. Kështu, sipas ligjeve shkencore dhe parimeve të shkakut dhe pasojës, ajo ka lëvizjen dhe evoluimin e saj. Si rrjedhim, ajo nuk është një vegël për t'u përdorur nga ky apo ai person. Ajo s'është një proces jologjik apo i rastësishëm pa asnjë qëllim.

Duke qenë se rrjedha e historisë është shkencore, nëse do gjendesha në mes të kësaj rrjedhe, nëse do zbuloja saktësisht ligjet e lëvizjes së historisë, unë do mund të parashikoj fatin e çdo shoqërie ose shoqërisë të tjera këtu e treqind vjet. Është po ashtu si meteorologjia ku duke njohur ligjet e atmosferës, që janë ligje logjike shkaku dhe pasojë, mund të parashikohen saktësisht ndryshimet e motit: ngritja dhe rënia e temperaturës, mundësia e rreshjeve, ardhja e reve, shpeshësia e stuhive dhe fryrja e erërave.

Prandaj, nëse zbulojmë rrjedhën e lëvizjes së historisë, ne mund të gjejmë se ç'është ndodhë në të ardhmen. Një person që i përmbahet këtij parimi, që beson në një filosofi të historisë ose ende më mirë, një shkencë të historisë, beson se historia është një realitet shkencor dhe një lëvizje që rrjedh në përputhje me ligje të përcaktuara shkencore. Pra, fati i njerëzimit përgjatë kohërave nuk është i rastësishëm. Ai nuk bëhet nga individë, e as nuk qëndron, lëviz, anon apo përparon sipas dëshirave të këtij apo atij personi. Ai lëviz sipas ligjesh të pranishme shkencore të përcaktuara që ekzistojnë në vetë fabrikën e shoqërisë dhe të kohës. Kjo lëvizje që ndodh në përputhje me ligjin shkencor në shoqëri quhet *histori*.

Prandaj, historia është një rrjedhë e vazhdueshme deterministe që lëviz sipas ligjesh të veçanta të përpikta. Ja se ç'është thotë të besosh në filosofi të historisë.

Por, si lëviz ajo? Sipas cilave ligje shkencore? Si mund të parashikohen ato? Ç'drejtim merr ajo? Përgjigja ndaj këtyre pyetjeve krijon filosofinë e veçantë të historisë së çdo shkolle mendimi. Secila shkollë mendimi i përgjigjet këtyre pyetjeve sipas vështrimeve të saj. Duke qenë se 'shkenca e historisë' nuk është zbuluar ende, ose deritani s'është njohur dhe pranuar plotësisht nga të gjithë, ne e projektojmë atë në një shkollë ideologjike si 'filosofia e historisë' dhe jo si një shkencë e vërtetuar dhe e rrënjësor.

Ideologjia

Ideologjia përfshin si bindjen ashtu edhe të njohurit e saj. Kjo d.t.th. të paturit e një qëndrimi të veçantë dhe vetëdijeje që një person zotëron në lidhje me veten, vendodhjen e tij klasore, bazën shoqërore, gjendjen kombëtare, fatin e botës dhe të historisë si dhe fatin e shoqërisë së vet nga e cila ai varet. Sipas ideologjisë shpjegohen pikat e mësipërme dhe në bazë të saj gjehen përgjegjësitë, përkushtimet, drejtimet, zgjidhjet, dëshirat, qëndrimet dhe gjykimet e veçanta. Si rrjedhojë, ai i bashkangjitet një sjelljeje dhe sistemi etik vlerash të posaçëm. Kjo d.t.th se është sipas botëkuptimit dhe llojit thelbësor të shoqërisë, antropologjisë filosofike dhe filosofisë së historisë që një person formon bindje mbi jetën, marrëdhënien ndaj 'vetes', të tjerët dhe botën.

Ajo bën të qartë si duhet jetuar, ç'duhet bërë, ç'lloj shoqërie duhet ndërtuar, si krijohet një sistem shoqëror ideal, cilat janë përgjegjësitë dhe detyrat e një individi ndaj shoqërisë së tij; ç'lloje konfliktesh, marrëdhëniesh, idesh, nevojash, bindjesh, vlerash negative ose pozitive, sjelljeje të përbashkët, matëseje të së mirës dhe së keqes, identiteti shoqëror dhe njerëzor duhet krijuar dhe vendosur.

Prandaj, ideologjia është një sistem bindjesh që interpreton orientimin shoqëror, racional apo klasor të një qenieje njerëzore si dhe sistemin e tij të vlerave, rendit shoqëror, formës së jetesës, individit ideal, gjendjes shoqërore dhe jetës njerëzore në të gjitha përmasat e saj të ndryshme. Ajo i përgjigjet pyetjeve: I cilit lloj jeni? Çfarë bëni? Ç'duhet të bëni? Ç'duhet të ndodhë?

Aspektet e ndryshme të infrastrukturës (d.m.th. botëkuptimit) dhe suprastrukturës (antropologjisë filosofike, sociologjisë dhe filosofisë së historisë që formojnë një ideologji)

gjejnë domethënie, mund të kuptohen dhe kthehen në jetë si dhe ngrihen në (nivelin e një) shkollë, kur të jenë qartësuar dy pika: pikëpamjet e saj mbi qytetin ideal dhe njeriun ideal.

Shoqëria Ideale (Utopia)

Utopia është shoqëria ideale që konceptohet në mendjen e dikujt, dëshirat dhe përpjekjet për të, me qëllim që shoqëria njerëzore të marrë atë formë. Të gjitha filosofitë, fetë dhe qeniet njerëzore kanë një lloj të ndryshëm utopie në mendje. Parajsa është utopia apo shoqëria ideale në mendjen e njeriut fetar. Utopia e Platonit ishte qyteti ideal për grekët aristokratë dhe intelektualët e kohës së tij. Qyteti i Zotit i Shën Agustinit, Qyteti i Shenjtë i Gjon Isolahit si dhe Shoqëria e Drejtësisë së Gjithësishtme të shi'itëve, në fund të fundit, janë të gjitha shoqëri ideale.

Në shumë prej librave të lashtë, qytetet ideale si filozofia e Jabalwasë dhe Jabalsasë - qytete me njerëz, qeveri, fë, organizim politik, klasa shoqërore, etike, themele shoqërore, mendime dhe kulturë idealiste. Prandaj, në kundërshtim me atë që pohohet në mënyrë sipërfaqësore, krijimi i utopive është rrjedhojë e një nevoje të çdo idealisti apo njeriu të drejtuar nga një qëllim.

E gjithë kjo tregon se dëshira për të patur një formë më të lartë shoqërie ekziston edhe në natyrën parësore (*fitrah*) të secilës prej qenieve njerëzore si dhe në ndërgjegjen e çdo shoqërie. (Ajo) është shpalosja e shpirtit në zhvillim të çdo njeriu.

Kjo 'formë më e lartë e shoqërisë' në një shkollë mendimi nuk është një shoqëri e përfytyruar apo e sajuar, por një shoqëri e përkryer që ndërtohet nga ideologjia e asaj shkollë mendimi. Kjo është kështu sepse përkrahësit e secilës shkollë mendimi besojnë në një mënyrë jetese njerëzore, të lirë dhe të përsosur e jo vetëm në *mundësinë* e një jete të tillë dhe sigurisë së saj, por përpjekjen për ta *krijuar* atë.

Forma e dëshiruar, ideale apo më e lartë e shoqërisë është pamja ideale mendore e asaj shoqërie të cilën një individ ose grup që beson në atë shkollë mendimi kanë për të; dhe ata përpiqen ta ndryshojnë shoqërinë njerëzore drejt atij lloji shoqërie.

Në thelb, ekzistenca e një shoqërie të përfytyruar vërteton se njeriu lëviz gjithmonë nga 'gjendja e tanishme' drejt një 'situatë më të dëshiruar', qoftë kjo imagjinare, shkencore, utopia e Platonit apo shoqëria pa klasa e Marxit. Por shoqëria e shumëdëshiruar në një shkollë mendimi është një shoqëri shkencore dhe potencialisht objektive që ndodhet në harmoni me shpirtin dhe orientimin e asaj shkollë mendimi, e bazuar në botëkuptimin e saj dhe në përputhje me qëllimin e vet përfundimtar dhe filozofisë së jetës në të.

Prototipi Ideal

Njeriu i përkryer nisat nga dëshira se "ç'duhet të jetë" dhe "ç'duhet të bëhet" ai. Ishte ky lloj njeriu që mistikët synonin të arrinin. Prototipi universal (*insan-i-kamil*) përmendet qartë në risalet tona, sidomos ato mbi filozofinë (*hikmat*) dhe ndriçimin (*isbraq*). Ky është personi që ka arritur nivelin më të lartë që një njeri mund të arrijë dhe (drejt të cilit mund të) zhvillohet. Është një individ që e ka çliruar veten nga vargonjtë e 'epshit' dhe 'pasionit' dhe që është ngritur lart si njeri.

Fashizmi flet për 'supernjeriun'. Nietzsche flet për njeriun që bëhet trashëgimtari i perëndive. Hegeli, në filozofinë e tij të historisë - e cila bazohet në idealizmin e tij të veçantë - parashikon një të ardhme në të cilën 'ideali absolut' pasi të ketë kaluar etapat e

evoluumit të vetë-ndërgjegjësimit të formës më të lartë të njeriut, arrin 'vetëdijen absolute' dhe në këtë etapë, prototipin universal.

Socializmi etik i shek. XIX në Gjermani, në të cilin besonin shumica e nxënësve të Hegelit, përpiquej të arrinte njeriun e një 'prirjeje të shëndoshë', 'njeriun që është human', talentet e të cilit kanë përparuar lirshëm dhe arsyeshëm duke luftuar si kundër 'kësaj bote' borgjeze ashtu edhe 'asaj bote' të përshtirtshme, sepse të dyja e bëjnë njeriun të metë, të metamorfozuar dhe të përhuajtuar nga e vërteta e 'vetes' dhe natyrës fillestare.

Edhe marksizmi madje, që bazohet në 'materializëm' siç e shpjegojnë intelektualët tanë - 'qenia njerëzore' për ta është një kafshë ekonomike - flet për një 'qenie njerëzore të tërësishme'. Ky person është i tërësishëm, i plotë dhe i përkryer. Ai nuk është bërë i papërkryer, i paralizuar, i coptuar apo i tjetërsuar. Ai nuk është tjetërsuar nga sistemi apo bërë i metamorfozuar. Ai nuk vuan nga një ndjenjë vetë-humbjeje. Ai nuk e adhuron kamjen. Ai nuk është një-përmasësh. Ai s'është as kolonizues e as i kolonizuar. Ai nuk është as pronar e as skllav. Ai nuk është ndjekës epsesh, murg apo asketik. Ai nuk është një punëtor pa punë për shkak të ekzistencës së elementeve reaksionare dhe të devijuara, rrethanave ekonomike, sistemit klasor dhe kushteve çnjerëzore të punës.

Prandaj, të gjitha shkollat e mendimit, qofshin materialiste apo mistike, kanë një koncept mendor të një 'lloji të përkryer', një personi të tërësishëm, një prototipi ideal të njerëzimit. Përndryshe, një fillosofi shoqërore, një shkollë etike mendimi dhe një rrugë për t'u ndjekur në jetën e njeriut është e pakuptimtë sepse (atij) i mungon orientimi.

Një model njerëzor është ai që jep drejtim dhe na bën të lëvizim. Ai kërkon që edhe duart edhe mendimet tona të vihen në përdorim për kërkimin apo arritjen e atij modeli.

Modeli mund të përdoret si një matës i jetës, një etikë, një mjet për të edukuar dhe mësuar njerëzit. Nuk është e mundur të disiplinohen njerëzit pa pranuar prototipin universal dhe pa patur një të tillë për racën njerëzore. Ne duhet të njohim njeriun potencial më qëllim që ta krijojmë atë person nëpërmjet një teknike apo metode të zhvilluar, të saktë dhe shkencore.

Disiplinë d.t.th 'të bëhesh një qenie njerëzore' dhe ta sjellësh njeriun afër prototipit universal. Nëse i pyesim ata që janë të angazhuar në edukimin e qenies njerëzore se ç'kanë ndër mend se do bëhet çdo person, ata s'mund të përgjigjen se një problem i tillë s'paraqet ndonjë interes sepse ata synojnë të ndryshojnë pozicionin e tanishëm të njeriut. Prandaj, prototipi universal duhet të jetë i qartë dhe të bëhet e ditur se ç'lloj njeriu përbën ai.

Ata s'mund të pohojnë: "Ne jemi ekspertë dhe (si të tillë) mbajmë përgjegjësi vetëm për edukimin dhe mësimin e tyre. Prototipi universal nuk na intereson. Është në dorë të fillosofisë dhe fesë ta bëjnë të qartë atë." Një edukim dhe mësimdhënie e tillë i ngjan një zdrukthëtarit që ka mbledhur njëqind copa pajisjesh dhe lloje të ndryshme druri e punon mjeshtërisht me to, por që kur e pyesni se çka po punon, ai përgjigjet: "As që ia kam idenë. Unë jam realist. Nuk jam idealist. Unë vetëm pres dru por s'ia kam idenë se përse shërben dhe se kush do e përdorë."

Ne duhet të konsiderojmë çështjen se sistemi i vlerave njerëzore është i përcaktuar nga prototipi universal që ndodhet në mendimet tona dhe që ne besojmë të jetë një qenie njerëzore shembullore, një model simbolik, njeriu i ngritur që duhet të arrijmë e që s'jemi ende. Qëllimi dhe përpjekja kryesore e edukimit dhe formimit është t'i bëjë qeniet njerëzore të rriten gjithnjë e më të ngjashme me këtë model brez pas brezi. Prandaj, çdo shkollë mendimi duhet ta paraqesë idealin e saj të prototipit universal, përndryshe krejt përpjekjet e saj janë të kota dhe lëvizja e saj - pa qëllim.

Duhet vënë re ajo se një prototip universal apo shoqëri që lëviz drejt simbolesh të lartësuar, idesh dhe modelesh shembullore shkatërron gjithmonë kallëpe dhe standarde të rrënjosura përgjatë rrugës. Individit apo shoqëria prototipe universale është forca tërheqëse

që bën të njohur orientimin e një lëvizjeje por që nuk shpreh formën përfundimtare ose të palëvizshme.

Është faktori i lëvizjes që hedh poshtë faktorët frenues dhe ndalues. Standardet e palëvizshme dhe të ngurta e vendosin njeriun në forma dhe përmasa të parandërtuara. Ai e trajtëson njeriun në siç do dhe duke synuar idealin ai lëshon një individ nga këto trajta dhe e nxjerr atë person nga prapambetja të çdo fazë veprimi dhe sistemi. Ai e zhvendos njeriun në rrymat e kohës drejt oqeanit dhe/ose përjetësisë absolute.

Prandaj, siç përmenda në fillim të ligjëratës, po ashtu siç nuk besoj në kallëpe të ngurta dhe të parandërtuara, po ashtu nuk besoj në paangazhim, papërkushtim dhe papërgjegjësi. Në vend të lëshimit apo kufizimeve, unë besoj se orientimi duhet përzgjedhur jo në 'trajtën e tij të të qenurit' e as në 'të qenurit pa formë', por përkundrazi në si një bërje të përjetshme evoluese, një lëvizje e përgjithmonshme dhe shtegtim - jo për të arritur një pikë, por për t'u orientuar drejt një rruge.

Prandaj, një model për një shkollë mendimi përbëhet prej një infrastrukture të një botëkuptimi dhe një superstrukture të një filozofie në lidhje me qenien njerëzore, shoqërinë dhe një filozofi të historisë (shtyllat kryesore) të cilat formojnë ideologjinë e dikujt, duke zhvilluar shoqërinë ideale dhe qenien njerëzore ideale.

Shkolla e Islamit

ZOTI

Mekëmbësi i Zotit në tokë:

Ndërgjegjësim

Liri

Krijueshmëri

Udhëbeqës

Prototipi i Shkollës së Islamit

Bashkësia Islamike

Libra/Shkallë/Hekur

Udhëbeqje: Revolucionare e Përkohshme

ISLAMI

Dialektika: Kaini prb. Abilit

Profetësia/Udhëbeqja

Demokraci e Përkushtuar (okultacion)
Revolucion Botëror

Dialektika: {
Balta prb Shpirtit
Shpirti Hyjnor prb Iblisit

Katër burgjet: natyra, historia, shoqëria, vetja

Dialektika: {
Kaini prb. Abilit
Tirani/Drejtesi

Qenia Njerëzore

Monoteizmi

Shoqëria

Shqipëroi: Edin Q. Lohja,
Maj 2000.